



ECK MAGAZINE

- Shkëmbim semestral në Nidge University
- Fakte të mahnitshme për psikologjinë e të mësuarit
- Intervista me studentët dhe me stafin akademik
- Studentët Ambasador të ECK



**EUROPEAN
COLLEGE
OF KOSOVO**



ECK MAGAZINE

Nr. 2/3

Shkëmbim semestral në Nidge University

Fakte të mahnitshme për psikologjinë e të mësuarit

Intervista me studentët dhe me stafin akademik

Studentët Ambasador të ECK

Prishtinë, 2015

Përmbajtja

• SHKËMBIM SEMESTRAL NË NIGDE UNIVERSITY, TURQI	2
• STUDIM SEMESTRAL NË VARNA FREE UNIVERSITY	3
• INTERVISTA ME PROFESORIN PROF. BEKIM SEJDIU	4
• ECK Student Ambassadors	5
• 4th Law of "48 Laws of Power"	6
• TË MËSOJMË NGA LIDERËT	7
• TRAJNIMI MË INOVATIV NË KOSOVË PËR JURISTË - PRAKTIKA JURIDIKE	8
• Trajnime falas për studentët e Kolegjit European të Kosovës -	9
• Mistere të pa zbuluara ende nga shkenca	10
1. Gurët gjigantë sferikë të Kosta Rikës	10
2. Qyteti i humbur i Atlantis	10
3. Misteri i pa zgjedhur i Stonehenge	11
4. Dorëshkrimi Voynich	11
5. Trekëndëshi i Bermundës	11
6. Rrathët e çuditshëm në Namibi	11
• A janë duke na bërë telefonat smart më pak të menqur ?	12
• Vlerat e fitnesit	13
• Menaxhimi i kohës	15
• Fakte të mahnitëshme në lidhje me psikologjinë e të mësuarit dhe kujtesës	17
• Mjedisi se ku mësoni është shumë i rëndësishëm për performancën në mësim	17
• Teknikat që ndihmojnë të mbajturit në mend	18
• Një fakt interesant rreth të mbajturit në mend	19
• Kuriozitete	20
• Thënje motivuese nga njerëz të famshëm	22

ECK Magazine Editoriali:

Prof. Msc. Fatlum Gogiqi • Albana Kasabaqi • Marigona Avdyli • Labinot Bajgora • Arian Kadriu

SHKËMBIM SEMESTRAL NË NIGDE UNIVERSITY, TURQI

Falë Bashkimit Europian dhe projektit Erasmus+, Kolegji Europian i Kosovës tani e tutje ofron mundësi studimi një semestral në Nigde University, Turqi. Në kuadër të Erasmus + dhe projektit të realizuar studentëve, ju mundësohet që të transferohen në NIGDE University për një semestër, ku pas përfundimit kreditë e lëndëve ju transferohen në ECK.

Kriteret për aplikim :

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e rregullt të vitit të dytë apo tretë në drejtimin Menaxhment apo Teknologji Informative.
- Të ketë notën mesatare mbi 8.00.
- Të zotëroj njohuri të Gjuhës Angleze.
- Të plotësoj Aplikacionin(Aplikacioni gjendet në ueb-faqe)
- Certifikata e notave
- Foto (jo më të vjetër se 6 muaj)

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në info@eck-edu.org
Afati i fundit për aplikim deri më 19 Nëntor 2015

Shpenzimet të cilat do të mbulohen përmes programit Erasmus +:

- Shpenzimet e Studimit një semestral
- Shpenzimet e Udhëtimit: 275 € për person
- Shpenzimet e qëndrimit: 457 € për semestër për person
- Shpenzimet e konviktit me mëngjes dhe drekë: 150 €për një semestër të paguhet nga shuma e grant-it prej 457 Euro.

Për më shumë informata ju lusim të kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në Kolegjin Europian të Kosovës !



STUDIM SEMESTRAL NË VARNA FREE UNIVERSITY

Mundësitë për studime jashtë vendit nuk kanë të ndalur për studentët e Kolegjit Europian të Kosovës. Tani e tutje përveç mundësisë për studime në New York, Barcelonë, Gjenevë, Mynih, Montreux, Istanbul ju keni mundësinë të studioni pak metra nga deti i zi në Varna Free University në Bullgari. Falë bashkëpunimit në mes Varna Free University dhe Kolegjit Europian të Kosovës, studentëve ju krijohet mundësia për studime në Varna Free University në Bullgari, universiteti i parë privat dhe më i madhi në Bullgari.

Fushat në të cilat studentët e ECK mund të transferohen për një semestër dhe pastaj të transferojnë kreditë në Kolegjin Europian të Kosovës:

- Teknologji Informative (30 kredi)
- Menaxhment (30 kredi)
- Juridik (30 kredi)

Pagesa: 1200 Euro (30 ECTS dhe kosto e studimit). Në këtë çmim nuk është i përfshirë çmimi i transportit, akomodimit dhe ushqimit.

Kriteret për aplikim :

- Plotësimi i formës për aplikim
- Fotokopja e pasaportës
- Certifikata e notave
- 2x Fotografi
- Njohuri të gjuhës angleze, niveli (B1)

Gjatë kohës që ju kaloni në Varna Free University ju keni mundësinë të merrni pjesë në workshopet, aktivitetet sociale dhe sportive të cilat organizohen në Varna. Gjithashtu, vlen të ceket që Varna është zgjedhur si një nga qytetet më atraktive për të rinjtë falë bukurisë dhe aktiviteteve të cilat ofron.



1. Cila ishte ëndrra juaj e fëmijërisë ?

Një nga bukuritë e veçanta të fëmijërisë është se ajo ka shumë ëndrra. Pak prej tyre i mbijetojnë kohës, sepse i tretë pjekuria e moshës dhe dallgët e jetës që sjellin vitet. Sigurisht që, si çdo fëmijë supozoj, kam patur shumë ëndrra. Ëndrrat janë lidhur me heronjtë që përshkojnë imazhet fëmijërore. Padyshim, këtu prindërit dhe mësuesit ndërtojnë modelin e parë, në psikologjinë e çdo fëmiu. Ëndrrat për t'u bërë si prindi ose mësuesi, ëndrra për t'u bërë sportist me nam, për t'u bërë oficer ushtarak , më vonë i lanë vend ëndrrave të tjera,që lidhen sidomos me profesionin dhe rrethin social.



2. Na tregoni mbi rrugëtimin tuaj si Ambasador i Republikës së Kosovës ?

Për të vazhduar me tregimin e ëndrrave, ne kemi patur një ëndërr kolektive dhe, domosdo, individuale, për ta bërë Kosovën të lirë dhe demokratike. E pranoj që unë, sikundër edhe shumica e bashkëmoshatarëve të mi, nuk kemi pasur "kapacitet," e them kushtimisht, për të menduar apo imagjinuar se çfarë mundësish personale, për sa i përket karrieres profesionale, vijjnë me lirinë dhe shtetin tënd që të shërben, si antipod i atij të huaj që të shtypë.

Dhe, fare natyrshëm, kur të bie hise që të jesh në 10-ëshen e parë të diplomatëve të Republikës së Kosovës, të shtetit që mishëron një ëndërr të madhe, detyrën e diplomatit e trajton si mision, në kuptimin më domethënës të fjalës.

Unë jam emëruar si i Ngarkuar me Punë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Turqi, në verën e vitit 2008. Në tetor 2008 "kam zbarkuar" në Ankara, së bashku me Zëvendësin tim, z. Gyner Ureja, me mision për të përfaqësuar diplomatikisht Republikën e Kosovës dhe me detyrë primare hapjen sa më të shpejtë të Ambasadës. Dy diplomatë të rinj, në moshë dhe, kuptohet, në përvojë diplomatike, me nga një llaptop, një vulë të Ambasadës dhe disa dokumente dhe materiale të tjera dhe, mbi të gjitha me shumë entuziazëm dhe krenari të papërshtuar, për shkak të detyrës që na ishte besuar. Ambasada e Republikës së Kosovës në Turqi u hap me 17 dhjetor 2008. Në shtator të vitit 2009 unë u promovova si Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Kosvoës në Republikën e Turqisë. Përtej anës emocionale, që nuk ka si të mos jetë pjesë e tregimit, shërbimi diplomatik në emër të shtetit të Kosovës, si në Turqi , gjatë viteve 2008-2012, e poashtu edhe ne Nju Jork (si Konsull i Përgjithshëm), gjatë viteve 2012-2014, ka patur plot sfida, momente të këndshme por edhe ditë të vështira, gëzime për sukseset, por edhe frustim për mosukseset.

3. Pjesa më e mirë e punës si Ambasador ?

Për mua kanë qenë tri të tilla: Së pari, siç e thashë më lartë, sukseset në arritjen e objektivave, që në masë të madhe kanë patur të bëjnë më procesin e forcimit të pozitës ndërkombëtare të

Republiës së Kosovës. Njohjet e shtetit të Kosovës; lidhjet e marrëdhënieve diplomatike; vënja e Kosovës në agjenda të takimeve të rëndësishme bilaterale, apo në agjendat e mekanizmave multilateral , marrja e informacioneve me rëndësi apo transmetimi i qëndrimeve, interesave dhe imazhit të Kosovës, në audienca dhe platforma të ndryshme, kanë qenë objektiva të pasqyruara në agjenda ditore të punës së misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës. Roli sado i vogël në sukseset e shënuara në cilëndo nga këto drejtime, më ka krijuar gjithmonë ndjenjë të veçantë. Ajo ndjenjë vetëm mund të përjetohet, jo të përshkruhet.

Përtej kësaj, përvoja e të jetuarit në metropole dhe gravitimi dhe kontaktet me qarqe sociale elitike, sidomos me diplomat, është shkollë në vetvete - flas si përvojë profesionale dhe jetësore.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, duhet ta potencoj fuqimisht dhe me mirënjohje të thellë se një kënaqësi dhe frymëzim të veçantë për punën time, flas gjithmonë në rrafshin profesional, ka qenë bashkëpunimi me diasporën tonë në Turqi dhe, sidomos, në Nju Jork. Mbështetja që kam gëzuar nga diaspora ka qenë burim i fuqishëm frymëzimi për punën time, si dhe lehtësim i madh për mua dhe familjen, për të jetuar dhe vepruar në vende të huaja.

4. Cili është hobi juaj ?

Nuk kam ndonjë hobi të veçantë. Pëlqej dhe bëj sport, të paktën një herë në javë . Pavarësisht se me pëlqen noti dhe basketbolli, rrethanat me imponojnë që sporti që e praktikoj të jetë, kryesisht, fitnesi. Mund të luaj disa melodi me kitarë. Por, edhe pse e pëlqej shumë kitarën, nuk kam arritur ansjherë të kaloj përtej disa gjërave shumë themelore. Një kohë, sa kam shërbyer në diplomaci, kam qenë koleksionues i karikaturave politike - kryesisht të politikës ndërkombëtare. Leximin e konsideroj pjesë të përditshmërisë, jo hobi. Përpiqem të lexoj, për aq sa mundem, letërsi dhe histori. Pra, literaturë që jo domosdo lidhen me punën dhe profesionin aktual.

Mbi të gjitha, përpiqem të kemi gjithmonë kohë për familjen. Ajo është burimi kryesor dhe i pashterrshëm frymëzimi dhe gjenerator i energjive për jetë dhe punë.

5. Cili është libri i preferuar që do t'ia rekomandonit studentëve për ta lexuar ?

Jashtë literaturës profesionale dhe publicistike, disa prej librave që më kanë lënë përshtypje janë: "Les Miserables" e Hygosë dhe "Animal Farm" e Orwell-it. E para paraqet një ndërthurje të jashtëzakonshme të elementeve nga teologjia, sociologjia, filozofia dhe historia politike. E dyta përshkruan në mënyrë fascinuese idenë e revolucionit në emër të barbarësisë dhe rreziqet e mëdha socio-politike që sjellë degjenerimi i idesë, përgjat jetësimit të saj - sidomos nëse mendohet që ajo të jetësohet kundrejt një sfondi të vobektë socio-kulturor. Kuptohet, që të dyja janë fiksione, si romane, por të tilla që shpërfaqin një lexim të thellë të fenomeneve socio-politike që i pasqyrojnë përmes tregimeve fiktive.

6. Sekreti i suksesit në profesionin si Profesor ?

Nuk ka një të vetëm. Në vija të përgjithshme, tek profesori i suksesshëm gërshetohet elementi pedagogjik me sasinë e dijes profesionale. Kuptohet, paraprakisht duhet ta duash punën e Profesorit dhe të keshë disa shkathtësi të lindura, të cilat mund t'i avancosh me ngritje intelektuale (si për shembull oratoria, aftësia për të komunikuar me të tjerët, etj). Në një rrafsh më praktik,

konsideroj se është shumë me rëndësi që profesorët të dijnë se çfarë është me rëndësi për të mësuar studentët - flas për lëndën mësimore, si dhe cili është optimumi dhe maksimumi i dijes, të cilën ata duhet ta demonstrojnë në vlerësimin që iu bëhet (i cili, gjithsesi, duhet të jetë kontinuel). Për shembull, ajo që duhet ta dijë studenti i vitit të 2-të dhe ai i studimeve master, në të njëjtën lëndë, nuk duhet të jetë e njëjtë.

7. Po të kishit mundësi të zgjidhni një profesion tjetër, cili do ishte dhe pse ?

Nuk kam një përgjigje të qartë. Preferoj profilin multidiciplinar të akademikut. Kjo zgjeron dhe pasuron dukshëm parametrat e të gjykuarit intelektual. Për sa i përket punëve që bëjmë, këto shpeshherë nuk kanë të bëjnë me preferenca dhe plane paraprake. Pavarësisht se në rastin tim jam i kënaqur më punën që bëj.

8. Momenti më qesharak në jetën tënde ?

Ka shumë kuptohet. Jo të gjitha janë për t'u thënë, mbase. Më kujtohet, për shembull, sesi një herë në Turqi, kur isha me studime pas-diplomike para shumë vitesh, më ka rënë të përkthej shqip-shqip dhe anasjelltas....në mes të një shqiptari të Turqisë dhe një shqiptari nga Lushnja. Madje jo një herë por disa herë. Turqit pëshpërisnin duke thënë ja këta tre arrnautët që nuk mund të kuptohen në mes veti edhe pse flasin të njëjtën gjuhë.....Në momente të caktuara më krijohet bindja se, mbase, e kundërta do kishte me qenë më befasuese....

9. Mesazhi juaj për studentët e rinj ?

Shkollimi universitar është si ndërtimi i hartës. Harta të ndihmon të arrish tek një cak i caktuar. Ajo që synon secili person që mëton të kryej studime universitare është përgatitja për të jetuar me një profesion intelektual, i cili gjithashtu i siguron një status të caktuar shoqëror. Për të arritur të caku, harta duhet të jetë e hartuar mirë dhe qartë. Përtej metaforës, për të mos përfunduar, në fund të studimeve, me një diplomë/letër më pak vlerë, studentët duhet të mësojnë. Ata duhet të përgatiten për të qenë konkures me diplomën që do marrin. Konkures të bënë sasia e dijes që qëndron prapa diplomës universitare.

Poashtu, lidhjet miqësore dhe kolegiale që ndërtohen gjatë studimeve janë diçka me shumë dobi edhe pas përfundimit të tyre. Është mirë që ato lidhje të kultivohen dhe të zgjerohen në vazhdimësi.

Kuriozitete

- Nëse do të mund të përdornim 13% të trurit, do të mund të shfaqeshim nga një vend në një tjetër.
- Nëse damarët e njeriut do të vendoseshin njeri pas tjetrit do të mund të përshkronin Ekuatorin 2 herë.
- Shteti me më tepër rruge të asfaltuara është Franca.
- Muskuli më i fortë i trupit të njeriut është Gjuha.



Fatos Gerbeshi

Fatos Gerbeshi përveç dëshirës së tij për të ndjekur studimet universitare pranë Kolegjit European të Kosovës nuk ka lënë pas dore as pasionin e tij për muzikën.

Falë interesimit të madh për Muzikë, Fatosi qysh në moshë të re ka pasur nderin të mësonte dhe performonte pranë emrave të njohur siç janë Agim Gërbeshi dhe Sabri Fejzullahu. Dëshira e tij mbetet që një ditë të jetë një muzikant i njohur dhe sipërmarrës i suksesshëm.



Nol Abazi

Në anën tjetër jo larg muzikës kemi dhe fotografinë. Gjatë bisedës me studentin e vitit të dytë Nol Abazin mësojmë se gjithçka kishte filluar si një nder për një mik. "filloi si një nder i vogël për një shok timin dhe u kthye në hobi timin". Hobi i Nol Abazit bëri që përveç revistave ,reklamave dhe rrjeteve sociale, fotot profesionale të postohen dhe në disa nga faqet më të njohura ndërkombëtare siç janë: Luciano Men's wear, Gentleman's wear dhe Nohow style.



Kastriot Ramadani

Kastriot Ramadani, student i drejtimit Teknologji Informative dhe Biznes mbase është emër i njohur për dashamirët e sporteve luftarake. Kastrioti është personi i cili ka përfaqësuar Kosovën në arenën ndërkombëtare të Taekwondos dhe njëkohësisht ka arritur shumë suksese. Filloi në vitin 2000 të merrej me sportin e Taekwondos, ndërsa arritja më e madhe ishte fitorja ndaj nën-kampionit botëror në Taekwondo në vitin 2012.

Kastrioti pritet të marrë pjesë gjatë muajit Dhjetor në Kampionatin Kombëtar të Taekwondos në Kosovë. Më shumë se 30 medalje, është numri i medaljeve në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë që ka Kastrioti, kryesisht vendi i parë dhe dytë.

4th Law of "48 Laws of Power"

When you are trying to impress people with words, the more you say, the more common you appear, and the less in control. Even if you are saying something banal, it will seem original if you make it vague, open-ended, and sphinx like. Powerful people impress and intimidate by saying less. The more you say, the more likely you are to say something foolish. Transgression of the Law. Coriolanus was a great military hero of ancient Rome. People held him in awe, until he opened his mouth. He spoke his mind, hardly able to control his arrogance and boastfulness. He slandered and insulted people.

The more speeches he made, the less people respected him. He suffered the people's wrath and was eventually banished from the city. Observance of the Law: In the court of Louis XIV, nobles and ministers would spend days and nights debating issues of state.


They would confer, argue, make and break alliances, and argue again, until finally the critical moment arrived: Two of them would be chosen to represent the different sides of Louis himself who would decide what should be done. After these persons were chosen, everyone would argue more: How should the issues be phrased? What would appeal to Louis, what would annoy him? At what time of day should the representatives approach him, and in what part of the Versailles palace? What expression should they have on their faces? Finally after all settled, the fateful moment would finally arrive. The two men would approach Louis, always a delicate matter, and when they finally had his ear, they would talk about the issue at hand, spelling out the options in detail. Louis would listen in silence, a most enigmatic look on his face. Finally when each had finished his presentation and had asked the king's opinion he would look at them both and say: "I shall see". Then he would walk away.

The ministers and courtiers would never hear another word on this subject from the king. They would simply see the result, weeks later, when he would come to a decision and act. He would never bother to consult them on the matter again.

Wisdom in a nutshell:

- Saying less will keep you from saying something foolish or even dangerous.
- Once the words are out you cannot take them back.
- Keeping silent makes people reveal more about themselves. This is information you may be able to use against them later on.

Author of the book:
Robert Greene



“Të mësojmë nga liderët” është program akademik i Kolegjit European të Kosovës përmes të cilit synohet që studentëve përmes ligjëratave praktike nga ekspertë, zyrtar dhe personalitete të shquara të lëmive të ndryshme, t’u krijohet një pasqyrë rreth realitetit në tregun e punës dhe sfidat e së ardhmes.

Gjatë vitit akademik 2015/16, për dy semestra, në Kolegjin European të Kosovës ishin të ftuar plot 16 mysafir folës të cilët padyshim para studentëve dhe stafit të ECK treguan rreth sfidave të së ardhmes, storie suksesi si dhe prezantime nga tema të caktuara ekonomike dhe ligjore. Ligjëratat online nga Parisi, Roma dhe vendet tjera Europiane janë vlerësuar si risi më se interesante e cila mungonte në institucionet vendore në Kosovë.

z. Agim Shahini

Për vitin akademik 2015/2016 mysafiri i parë folës në programin akademik “Të mësojmë nga liderët” ishte Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit z. Agim Shahini.

Kolegji European i Kosovës pati nderin të ketë mysafirë folës, **z. Shahini**, i cili para studentëve dhe profesorëve të Kolegjit European të Kosovës prezantoi temën: **“Trendet e Zhvillimit Ekonomik në Republikën e Kosovës dhe Roli i Aleancës Kosovare të Biznesit”**

Vizita studentore në **“Tribunalin e Përherëshëm të Arbitrazhit të Kosovës”**

Një grup i studentëve të fakultetit juridik të **Kolegjit European të Kosovës** nën udhëheqjen e Prof. Dr. Qerim Qerimi realizuan vizitë studimore në **Tribunalin e Përherëshëm të Arbitrazhit të Kosovës**.

Qëllimi i vizitës ishte, njohja me kompetencat, procedurat dhe çështjet që janë objekt i trajtimit nga ana e këtij tribunal. Lidhur me qëllimin e themelimit dhe aspektet praktike procedurale të këtij tribunal.

Për veprimtarinë e tribunalit dhe rastet praktike studentët i njoftoj sekretari i Tribunalit të Përherëshëm të Arbitrazhit të Kosovës MA. Vegim Kraja.



EUROPEAN COLLEGE OF KOSOVO AKB

Aleanca Kosovare e Biznesit
Alliance of Kosovar Businesses

Kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit

AKB

GUEST SPEAKER SERIES

12/11/2015
17:00h
Salla A

z. AGIM SHAHINI

z. Agim Shahini do të prezantoj para studentëve të Kolegjit European të Kosovës temën: “Trendet e Zhvillimit Ekonomik në Republikën e Kosovës dhe Roli i Aleancës Kosovare të Biznesit”

tel: 038 22 28 28 email: info@eck-edu.org www.eck-edu.org

Kolegji Europian i Kosovës vazhdimisht ka ofruar risi në sferën e edukimit shkencor dhe profesional. Tash e dy vite, Qendra e trajnimeve e Kolegjit Europian të Kosovës duke dashur të kontribuojë në edukimin e të rinjve organizon trajnimin më inovativ në Kosovë për juristët "PRAKTIKA JURIDIKE". Ky trajnim mbahet në dy module (Moduli juridiko-penal dhe Juridiko-civil), dhe ka për qëllim që studentët dhe juristët të njohin dhe të mësojnë punët juridike edhe nga aspekti praktik.

Trajnimi ju mundëson kandidatëve që për një periudhë 8 javore të mësojnë/ushtrojnë në praktikë shkresat e ndryshme ligjore nga Prokurorë dhe Gjyqtarët më të mirë vendor si dhe synon të përgatit kandidatët për provim të Jurisprudencës në fushën penale dhe civile.

REALIZUESIT E TRAJNIMIT:

Realizuesit e trajnimit janë trajnerë-ekspertë të fushave përkatëse me përgatitje të lartë teorike dhe në veçanti praktike, të cilët kanë një eksperiencë të gjatë praktike dhe janë të punësuar drejtpërsëdrejti në institucionet më të larta publike-shtetërore siç janë: prokurorë, gjyqtarë, avokatë, ekspert të lartë të administratës publike etj.

z. Besim Kelmendi, Prokuror në Prokurorinë Speciale (Moduli Penal)

z. Rafet Haxhaj, Gjyqtarë në Gjykatën themelore (Moduli Civil)

KOSTO E TRAJNIMIT:

Trajnimi në total kushton **200€ (Moduli Penal dhe Civil)**. Pagesa prej 100 euro bëhet me rastin e regjistrimit ndërsa pjesa tjetër e pagesës prej 100 euro bëhet me fillim të modulit të dytë.

Në çmim janë të përfshira: materialet praktike të trajnimit, rreth 50 orët e trajnimit përgatitor praktikë, testi dhe certifikimi. Kandidatët që përfundojnë trajnimin do të marrin certifikatë për përfundimin e trajnimit "Praktika Juridike"



Trajnime falas për studentët e Kolegjit European të Kosovës

Si institucion i arsimit të lartë në Kosovë i cili vepron sipas metodave dhe sistemit evropian të mësuarit, Kolegji European i Kosovës për studentë gjatë gjithë studimeve ofron trajnime pa pagesë përmes të cilave synohet përgatitja e kandidatëve për tregun e punës.

Në vazhden e këtyre trajnimeve, më datë 14/11/2015 u realizua trajnimi për studentët e fakultetit juridik **“Metodat e Hulumtimit Shkencor dhe Shkrimi Akademik”**, i cili kishte për qëllim njohjen e studentëve me metodologjinë e re të hulumtimit shkencor dhe shkrimit akademik. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është që të ofrojë njohuri themelore dhe të udhëzojë studentët gjatë tërë procedurës, nga momenti i zgjedhjes së temës e deri te dorëzimi e mbrojtja e saj, lidhur me metodologjinë dhe teknikat e hartimit të punimit seminarik dhe të punimit të diplomës gjatë studimeve para-diplomike, në veçanti nga shkencat shoqërore.

Gjatë studimeve në nivelin Bachelor, studentëve të ECK ju ofrohet mundësia të ndjekin deri në 10 trajnime pa pagesë. Kjo mundësi ofrohet nga Qendra e Trajnimeve e cila është e certifikuar për trajnime dhe testime të shumta, ku ndër të tjera prezent janë dhe: Toefl dhe Toeic (USA), Pearson Test of English (Angli) si dhe Eipass nga Italia.

Hapësirë Reklamuese



URIME FESTAT E FUNDVITIT!

Tel: 044 220 065 049 220 065 038 220 065

WWW.FELLINI-KS.COM

1. Gurët gjigantë sferikë të Kosta Rikës

Në vitet 1930, kërkimet për të zgjeruar plantacionet e pemëve të bananeve në Costa Rica, rezultuan mjaft të pasura në një drejtim tjetër. U gjetën mijra sfera gjigante të gurta, disa prej të cilave ishin përsosmërisht sferike.

Gurët varionin që nga madhësia e një topi tenisi, në një diametër tjetër të jashtëzakonshëm prej 2.44 metër dhe me peshë 16 ton. Edhe pse janë qartësisht të krijuar nga njeriu, mbetet e panjohur arsyeja dhe qëllimi i tyre. Mbi të gjitha, nuk dihet sesi është arritur të ndërtohet një përpikëri e tillë sferike.



2. Qyteti i humbur i Atlantis

Qyteti i humbur Atlantis është një nga misteret më të vjetra dhe më të përhapur të botës. Që nga kohët e lashta, njerëzit janë përpjekur për të gjetur Atlantis, i cili besohet të jetë përmbytur pas një tërmeti apo cunami. Filozofi grek Platoni e përshkruan Atlantis si një ishull të madh që gjendej në afërsi të ngushticës së Gjibraltarit.


Sipas Platonit, qyteti i Atlantis ishte e mbushur me qytetarë të bukur, qyteti kishte një arkitekturë të mrekullueshme. Deri më sot, askush nuk ka qenë në gjendje për të gjetur qytetin-nënujor. Në lidhje me vendndodhjen e mundshme të tij eksploruesit, historianët dhe të gjithë ato që janë interesuar për të gjetur këtë qytet kanë dhënë teori të shumta. Historianë të panumërt dhe hulumtues kanë marrë pjesë nëpër ekspedita të ndryshme për të gjetur qytetin nënujor, po deri tani pa asnjë rezultat.



3. Misteri i pa zgjedhur i Stonehenge

Nuk ka dyshim që Stonehenge është një monument shumë i rëndësishëm, mendohet të jetë në planetin tonë prej më shumë se 5000 vjetësh. Gjatë shekujve është shqyrtuar e studiuar në të gjitha mënyrat, por qëllimi i tij dhe funksionaliteti i tij janë ende të panjohura.

Duke pasur parasysh të gjitha studimet e bëra, atëherë mund të themi se njëri nga misteret më të mëdha të botës është se si janë ndërtuar dhe pse?




4. Dorëshkrimi Voynich

Dorëshkrimi Voynich e mori emrin e vet nga Wojnicz një person me origjinë ruse, që e bleu atë në Fraskati për dyqanin e tij në Londër, nga Jezuitë të Kolegjit të Villa Mondragone në vitin 1912. Libri, i shkruar në pergamenë, përbëhet prej tekstit, i një gjuhe të panjohur, si dhe një sasi të konsiderueshme ilustrimesh me ngjyra, që përshkruajnë subjekte të ndryshme, si bimë, lule, yje, diagrame, ampula, shishe ,etj. Në këtë dorëshkrim gjendet "gjithçka", kjo të çon në dyshime, mister dhe një mijë hipoteza mbi origjinën e librit dhe natyrën e saj.



5. Trekëndëshi i Bermudës

Trekëndëshi i Bermudës, është një zonë e Oqeanit Atlantik në mes të ishullit Bermuda, bregdetit lindor të Floridës dhe Porto Riko. Ky trekëndësh, është në origjinën e një numri jashtëzakonisht të lartë i zhdukjeve të anijeve dhe të avionëve. Shpërthim i papritur i motorëve, humbjen e lidhjeve të radiove dhe shume fenomene te tjera të çuditshme, kanë ndihmuar në krijimin e kësaj legjende.



Disa kanë hedhur supozimin e një defekti të hapësirës së përkohshme, por shkencëtarët, në vend të kësaj hipoteze të krijuar, kanë përparuar në kërkimet e tyre hipotezën e turbullimit magnetik dhe shpërthimit të metanit. Të gjitha këto propozime hipoteza do të ngelen në zonën e teorisë për arsye sepse ato janë të paprovueshme.

6. Rrathët e çuditshëm në Namibi

Në disa lëndina me bar në Namibi për vite të tëra shfaqen rrathë të çuditshëm në të cilët nuk ka jetë, e që rëndom zhduken spontanisht pas disa dekadash. Rrathët më të vegjël zhduken pas mesatarisht 24 vjetëve, ndërsa ata më të mëdhenj madje edhe pas 75 vjetëve. Sipas ekspertëve amerikanë, që janë marrë me këtë fenomen, thuhet se ekzistojnë disa hipoteza mbi shkakun e paraqitjes së këtyre rrathëve, por asnjëra prej tyre nuk është bindëse.



Me gjithë përpjekjet e shkencëtarëve, deri më tani asgjë nuk i shpjegon këta rrathë të çuditshëm, të cilët vazhdojnë të jenë një nga shumë misteret interesante të pazgjdhura të planetit tonë.

A janë duke na bërë telefonat SMART më pak të mençur ?

Përdorimi i teknologjisë, kompjuterëve dhe celularëve të quajtur "smart-phone" për t'u futur në rrjetet e ndryshme të internetit, fillimisht ka qenë nevojë e të rinjve për të lehtësuar përditshmërinë në shumë aspekte, por tashmë një gjë e tillë është shndërruar në varësi. Shumë nga ne kontrollojnë telefonat mobil çdo minutë, madje edhe teksa jemi duke drejtuar makinën. Telefonat mobile janë pothuajse një fiksim.

Mesatarja e adoleshentëve pranojnë se i kontrollojnë rrjetet sociale të paktën 15 herë në ditë, ndërsa dërgojnë të paktën 17 mesazhe gjatë 24 orëve. Sipas ekspertëve këto zakone, media sociale dhe teknologjia, po bëjnë që të rinjtë të shfaqin shenja varësie që në moshë fare të vogël, gjë e cila mund të ketë pasoja serioze në të ardhmen.

Një telefon i mençur, duhet të jetë ngjitur në duart e çdo njeriu në Kosovë dhe jashtë saj, sepse komunikimi nëpërmes rrjeteve sociale e ka bërë një zëvendësim të komunikimit ballë për ballë.

Në një tavolinë me disa të rinjë dëgjon shumë pak fjalë, dhe shumë më shumë tekst – mesazhe, facebook dhe rrjete të tjera sociale!

Telefonat e mençur tani më janë shëndërruar nga një mjet i njerëzve "për një nevojë komunikimi më të lehtë në distanca", në një mjet "robërues" edhe kur ata janë të ulur ballë për ballë njëri tjetrit.

Dhe të gjithë ata që përdorin telefonat celular kanë një motiv të caktuar:

- Disa duan për të kaluar kohën,
- Disa lehtësimin e vetmisë,
- Disa duan argëtim,
- Dhe disa njerëz kërkojnë shoqëri ,etj.

Shikoni njerëzit të ulur nëpër restorante, kafiteri, në rrugë, në shkollë, në autobus, po thuajse të gjithë janë të "hutuar" duke shikuar në telefonat e tyre! A nuk është kjo një "skenë injorante" në mënyrën e shoqërimit dhe komunikimit ballë për ballë?

Pra kjo sëmundje shoqërore e shëndërruar në një epidemi globale, duket e pakontrolluar!

Sa më shumë kohë kalon aq më shumë miqësohemi me celularin, sa ndonjëherë na duket xhepi bosh pa të apo edhe dita. E rëndësishme është të mos e bëjmë atë pjesën më të rëndësishme të ditës, por kontaktin me njerëzit pasi në fund të ditës do të ndiheshim më mirë sikur të kishim folur ballë për ballë me dy miq sesa në celular me pesë të tillë.

(Artikulli i huazuar nga telegraf.com)



Vlerat e fitnessit

Të ushtruarit çdo ditë nuk na ndihmon vetëm për një fizik të bukur dhe të rregullt. Fitnessi ka provuar shkencërisht se ka shumë më tepër vlera. Ai shëron duke na përmirësuar ndjeshëm humorin, rrit kujtesën, na bën më të zgjuar, apo më pak agresiv.

Ideja se ushtrimi fizik mund të na bëjë të lumtur është për disa e papranueshme. Por përtej efekteve pozitive të ajrit të pastër dhe peizazhit, studimet tregojnë se edhe në rast se stërvtija kryhet në ambiente të mbyllura, është në gjendje të na bëjë të ndihemi më të kënaqur, madje edhe ta largojmë tërësisht depresionin. Në një studim të vitit të shkuar, shkencëtarë nga universitete amerikane nxorën në pah se ushtrimi i rregullt trupor prek hipokampin, zona e trurit përgjegjëse për gjendjen e humorit.



Fitnesi rrit inteligjencën

Aktiviteti fizik shton fluksin e gjakut në atë pjesë të trurit që është përgjegjëse për kujtesën dhe mësimin, duke ndihmuar prodhimin e qelizave të reja. Ndërkaq, në një tjetër test ku u përfshinë 241 vetë, të moshave nga 15 deri 71 vjeç, krahasoi aktivitetin fizik me rezultatet në testet perceptuese. Kërkuesit dokumentuan rezultatet më të mira mes njerëzve që ishin fizikisht më aktivë, sidomos në grupet e moshave më të reja

Ul agresivitetin

Është vërtetuar se ushtrimi fizik e ul agresivitetin, duke djegur energji. Fakti është që ushtrimi e bën trurin që të mos pushtohet fare nga agresiviteti. Zona para frontale e kores së trurit është ajo pjesë që vendos nëse duhet të bëjmë një veprim agresivë apo jo. Ulja e aktivitetit në këtë zonë, nga traumat apo nga funksioni jonormal, mund të shkaktojë paaftësinë për të kontrolluar impulset agresive. Ushtrimi fizik shton aktivitetin në këtë zonë, duke ndihmuar të menduarit me racionalizëm, i cili na bën të mendohemi mirë përpara se të ndërmarrim një veprim të dhunshëm.



Përmirëson kujtesën

Kur ushtrohem vëmë në përdorim qeliza nervore, të cilat ndihmojnë në krijimin e asaj që në shkencë përcaktohet si “rritësi i pjellorisë së trurit”. Ushtrimi fizik ndihmon në shtimin e fluksit të gjakut tek ato pjesë të trurit që janë përgjegjëse për kujtesën, duke përmirësuar funksionet e saj. Sipas studiuesve të ndryshëm ushtrimi fizik ndihmon më shumë nga gjithçka tjetër që njohim deri më sot për të përmirësuar kujtesën.



Lamtumirë duhanit

Duhanpirësit që dëshirojnë të heqin dorë kanë mundësi të shërohen nga ky ves nëse dinë se fitnesi është çelësi për çlirimin nga kjo varësi. Por, disa shkencëtarë britanikë thonë se edhe vetëm pesë minuta ecje e shpejtë mund të lehtësojë simptomat e varësisë ndaj nikotinit. Në disa teste, shkencëtarët u kërkuan pjesëmarrësve të klasifikonin nevojën për cigare pas llojeve të ndryshme të ushtrime.

(Artikulli i huazuar nga ikub.al)

Menaxhimi i kohës

Koha është diçka që ju mund të humbni dhe kurrë nuk kthehet më. Njerëzit gjithmonë dëshirojnë që të kishin më shumë orë në dispozicion në ditë. Zgjidhja për këtë problem të përbashkët është më e lehtë se sa dikush mund të kuptojë. Me disa rregullime të vogla në mënyrën se si ju përdorni kohën tuaj mund të ndryshojë mënyrën se si ju menaxhoni kohën tuaj. Menaxhimi i duhur i kohës është diçka që mund të ndryshojë jetën tuaj mbi një bazë themelore për të mirë.

1440 minuta të 24 orëve në një ditë. Kaq kemi të gjithë, mirëpo për disa nga ne, kjo kohë nuk mjafton. Studentët janë ata që zakonisht ankohen për mungesën e këtyre minutave.

Nëse dëshironi që të shfrytëzoni më mirë kohën dhe eventualisht të përmirësoni kualitetin e jetës ju duhet të shtoni disa parime që funksionojnë në të mirën tuaj. Menaxhimi i kohës ndihmon edhe në menaxhimin e stresit.



Mund të filloni zhvillimin e aftësive për menaxhimin e kohës duke ndjekur këta hapa:

- Krijoni një listë të gjërave që duhet të bëni dhe prioritetizoni ato.
- Për të organizuar veten shënoni gjërat që duhet të bëni.
- Kjo ju ndihmon të kontrolloni punët që keni bërë dhe që duhet të bëni.

- Mund edhe të shtoni kategori të punëve dhe në to t'i vendosni detyrat duke i prioretizuar qoftë në mënyrë alfabetike apo sipas rëndësisë.
- Filloni javën me një plan të punëve që duhet bërë.
- Kushtojani 15-30 minuta kohë që të përpiloni listën dhe do të ju ndihmoj që të jeni më produktiv gjatë javës.
- Po ashtu është mirë që të mbani ndonjë fletore, që të ruani çfarëdo ideje që ju bie ndërmend çfarëdo momenti.
- Në këtë mënyrë do të kuptoni gjërat që me të vërtetë kanë rëndësi për ju në këtë pikë.
- Zhvilloni shprehi më të mirë.
- Shprehitë që ju bëjnë kontra-produktiv, që sabotojnë qëllimet tuaja, dhe bllokojnë rrugën drejt suksesit duhet të largohen nga jeta juaj.
- Largoni një nga një dhe do të shihni rezultatet.
- Çelësi i aftësisë për menaxhimin e kohës është që të mos mbi ngarkoheni me punët që ju ofrohen.
- Krijimi i një rutine të qëndrueshme dhe eliminimi i pengesave eventualisht do të ju jap më shumë kohë. *(Artikulli i huazuar nga dritaislame.al)*



Kuriozitete

- Në tokë ekzistojnë 4 oqeane dhe 56 detëra që së bashku e formojnë "Detin Botëror" i cili përfshin 71% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës (316 mil.km²).
- Gjaku në organizmin e njeriut udhëton shumë shpejtë: prej zemrës deri te gishtërinjtë e këmbës arrin për 16 sekonda, deri në tru për 8s, deri në mushkëri vetëm për 6 s.
- Sipërfaqja e Tokës është 510.065.284 km katrorë. Kontinenti më i madh është Azia e cila përfshin 44.309.978 km katrorë (30% të sipërfaqes së përgjithshme tokësore). Shteti më i madh është Rusia e cila ka rreth 12% të sipërfaqes tokësore.
- 99% e arit gjendet në bërthamën e Tokës. Sikur të mund të nxirrnim këtë ar dhe të mbështillnim me të planetin, do të fitonim shtresën e arit të lartë 1.5 metra.

Fakte të mahnitshme në lidhje me psikologjinë e të mësuarit dhe kujtesës

Sipas hulumtimeve të bëra nga ekspertët në lidhje me kujtesën janë treguar fakte interesante. Duke filluar me një shembull, duke kujtuar diçka nga e kaluara juaj – themi një dhuratë të veçantë për ditëlindjen që keni blerë për dike vite më parë, ky fakt i thjeshtë duke kujtuar atë dhuratë të veçantë dobëson kujtime të tjera të ngjashme.

Psikologët thonë se ky fenomen i lejon njerëzit që në mënyrë aktive rindërtojnë kujtimet e kaluara.

Ndërsa njerëzit janë në dijeni se ata kanë krijuar këto kujtime të pasakta kjo mund të çojë në krijimin e kujtimeve të rreme dhe mund të mbështesë edhe zhvillimin e frikës irracionale. Kjo mund të argumentohet se në thelb krijoni të kaluarën tuaj për të shërbyer për nevojat e juaja dhe të ardhmen e vetë-identitetin.



Mjedisi se ku mësoni është shumë i rëndësishëm për performancën në mësim

Nëse ju keni dëgjuar ndonjëherë dikë duke diskutuar një ritual të çuditshëm që ata kryejnë në mënyrë që të përpiqen dhe të mësojnë diçka, atëherë del se ajo mund të funksionoj. Tregohet se të mësuarit varet shumë nga ku, si, me kë jeni dhe çfarë ka rreth jush. Nëse ju keni pasur ndonjëherë një nga ato ditë kur keni thënë “asgjë nuk po kuptoj” atëherë provoni të ndryshoni ambientin për rreth jush.

Hulumtuesit në Universitetin e Sidneit kanë treguar se të mësuarit është shumë i varur nga kushtet dhe vendi, kështu që për shembull në qoftë se ju jeni duke mësuar në lidhje me natyrën, atëherë për ju dhe kujtesën do të jetë shumë më mire në qoftë se ju jeni në një mjedis natyror sepse për të mësuar në lidhje me natyrën i ulur brenda do të jetë më e vështirë se sa i ulur diku në natyrë.



Teknikat që ndihmojnë të mbajturit në mend

Disa teknika për të mbajtur mend më mirë janë shumë të nevojshme në procesin e ruajtjes të informacioneve, ne mund ta ndihmojmë mendjen të memorizojë më shpejt. Truri ka tendencën të kujtojë më lehtë përmes referimit të imazheve, që kanë të bëjnë me vende apo njerëz, duke i shoqëruar konceptet me paraqitje konkrete. Pikërisht teknika asociative qëndron në bazë të disa teknikave për të mbajtur mend më mirë dhe na lejojnë të sjellim ndërmend atë ide që na duhet në një moment të caktuar.

Numrat

Nëse duam të mbajmë mend sekuenca komplekse shifrash, mund të përdorim teknikën e asociimit të numrit me një figure ose objekt të caktuar. Për shembull: numri një mund të imagjinohet si mollë, numri dy si mjellmë, treshi si një gjethë tërfili, katra si tavolinë, pesa si një yll me pesë cepa etj. Kështu çdo

herë që përpiqemi të kujtojmë diçka i referohemi formës. Këto imazhe përbëjnë një tërësi absurd që regjistrohet në kujtesë. Por në momentin që përpiqemi të sjellim ndërmend numrat, na mjafton të përzgjedhim imazhin dhe të nisim procesin e dekodifikimit.

Emrat

Është vërtetuar se mendja jonë memorizon më mire kur përdorim si referim objekte që kanë karakteristika të caktuara, p.sh. dimensione të mëdha, ngjyra që bien në sy, objekte në lëvizje, ireale etj. Rezultati duhet të jetë diçka që ka të bëjë me absurdën.

Kjo vlen edhe për emrat, të cilët gjithashtu sillen ndërmend si pjesë e një sekuence. Mjafton përdorimi i shkronjës së parë të çdo emri për të formuar një frazë jo të zakonshme, që mbahet mend lehtë.

Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynxmartinoi*)

Është kafshë e egër mishngrënëse dhe bën pjesë në familjen e maceve (Felidae), me trup deri një metër të gjatë, me qime të buta, të dendura e me ngjyrë të murrme lara-lara, me veshë të ngritur e me bisht të shkurtër. Shpërndarja aktuale e rrëqebullit ballkanik është e kufizuar në Ballkanin jugperëndimor, kryesisht zonat kufitare mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, duke u përhapur në veri në Mal të Zi dhe në Kosovë. Vlerësohen të jenë më pak se 100 dhe paraqet specien e rrëqebullit më të rrezikuar në tërë botën.

Biologjia, ekologjia dhe historia e rrëqebullit Ballkanik deri tani nuk ka qenë e kuptuar mirë ose e dokumentuar, por kërcënimet e dukshme nga faktori njeri kanë ndikuar në rënien drastike të popullsisë së rrëqebullit, të ushqimit (gjahut) të rrëqebullit, humbje dhe shkatërrim të habitatit të tij.



Rrëqebulli në Kosovë është kafshë e mbrojtur me ligj që prej kohës së Jugosllavisë, më saktë që nga viti 1973. Shpresojmë që kjo specie e bukur dhe unike të mbijetojë dhe gjeneratat e ardhshme mos të mësojnë për të si për një kafshë që ka pushuar së ekzistuari në trojet tona. Faktori njeri duhet të tregojë më shumë përkushtim për natyrën dhe pasurinë e vendit tonë. *(Artikulli i huazuar nga telegrafi.com)*

Hapësirë Reklamuese



ARIAN-CO
Construction Company

Thënie motivuese nga njerëz të famshëm

1. "Nëse jemi të bashkuar, e pamundura bëhet e mundur; nëse jemi të ndarë, e mundura bëhet e pamundur". - **Faik Konica**.
2. "Shumë pak të duhet për një jetë të lumtur, gjithçka ndodhet brenda vetës tënde, në mënyrën tënde të menduarit". - **Mark Aureli**.
3. "Karakterit është si një pemë ndërsa reputacioni si hija e saj. Hija është ajo që ne mendojmë, pema është gjëja e vërtetë". - **Abraham Lincoln**.
4. "Pesimisti sheh vështirësi në çdo mundësi, ndërsa optimisti sheh mundësi në çdo vështirësi". - **Winston Churchil**.
5. "Ne jemi pikërisht ajo që bëjmë vazhdimisht. Prandaj, përsosmëria nuk është një veprim, por një zakon". - **Aristoteli**.
6. "Një njeri krijues është i motivuar nga dëshira për të arritur, jo nga dëshira për të mundur të tjerët". - **Ayn Rand**.
7. "A doni të dini se kush jeni? Mos pyetni. Veproni! Veprimi do t'ju përshkruaj dhe do t'ju definoj". - **Thomas Jefferson**.
8. "Nëse doni të jeni të suksesshëm ju duhet të orientoheni në rrugë të reja, në vend se të futeni në rrugën e veshur me sukses të pranuar". - **John D. Rockefeller**.
9. "Sa më shumë njeriu mediton mbi mendimet e mira, aq më e mirë do të jetë bota e tij dhe bota në përgjithësi". - **Konfuci**.
10. "Do të fitojë, dëshira për sukses, shtytja për të arritur potencialin tuaj të plotë ... këto janë çelësat që do të hapnin derën për përsosmërinë personale". - **Konfuci**.

"Intelligence and courage
not always are combined
Often in a wooden house
a golden room we find."
Sarah M. Peterson

ÇKA ËSHTË HEALTH CENTER OF EXCELLENCE?

HCE është Platformë Globale Online për bashkëpunim shëndetësor, Qendër Referente për Mendim Sekondar dhe dosje personale shëndetësore.

HCE i ofron anëtarëve të saj mendim sekondar në Radiologji, Neurologji, Kardiologji, Patologji, Onkologji, Kirurgji, Gjinekologji etj, si dhe ekspertizë, nga mjekë vendor dhe ndërkombëtar. Ky shërbim do redukton dukshëm kohën për mjekim si dhe shpenzimet për udhëtim jashtë vendit.

Në Prill, 2013, në MEDETEL, Luxemburg, HCE ishte prezantuar në Forumin Botëror për Telemedicine dhe eHealth:

http://www.medetel.lu/download/2013/parallel_sessions/abstract/day3/Health_Center_of_Excellence.pdf

Përkrah partnerve të shumtë nga BE dhe SHBA, në Nëntor, 2014, HCE është bërë anëtare e European Connected Health Alliance: www.echalliance.com. ECHAlliance dhe HCE janë dakorduar të punojnë së bashku në një nivel strategjik për të promovuar iniciativat e përbashkëta shëndetësore.

HCE poashtu ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me AMS nga Republika Çeke, TakesCare nga Polonia, Cortrium nga Danimarka, dhe DicomGrid nga SHBA.

HCE poashtu ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me "International Scientific-Educational Innovative-Technological Consortium of Higher Educational and Institutions of Physical Education and Sports". Kjo marrëveshje do zhvilloj marrëdhënjet miqësore në mes të HCE dhe I.Ya. Horbachevsky Ternopil State Medical University, Ukrainë dhe institucioneve të edukimit të lartë - anëtare të konsorciumit.

Në Korrik, 2015, HCE ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me SIGAL- UNIQA Group, Kompani Lider për Sigurime Shëndetësore në Europën Juglindore. Nga Tetori 2015, platforma HCE USA është promotor dhe lider i mendimit sekondar dhe bashkëpunimit të mjekëve në mbarë globin.

AMBIENT ONLINE PËR BASHKËPUNIM DHE SHËRBIM SHËNDETËSORË

VIZIONI: Të fuqizoj bashkëpunimin e mjekëve dhe institucioneve të vendeve të ndryshme me qendra klinike dhe institute nga Europa dhe SHBA.

MISIONI: Të ofroj mendim sekondar për pacient dhe një ambient bashkëpunimi për profesionist mjekësorë.

PSE TË ANËTARËSOHEMI NË HEALTH CENTER OF EXCELLENCE:

- Antarëve iu ofrohet dosje mjekësore elektronike, mendimi sekondar dhe ekspertiza mjekësore online
- Mjekët mund të ofrojnë mendim sekondar për pacient dhe konsultohen me mjek, institucione tjera.
- Kompanive të sigurimeve shëndetësore, i ofron ekspertizë ndërkombëtare, mendim sekondar për klientët para dërgimit në tretman mjekësor si dhe dosje elektronike shëndetësore për klientët e tyre.



KOLEGJI EUROPIAN EDHE NË KOSOVË

REGJISTROHUNI NË KOLEGJIN EUROPIAN TË KOSOVËS DHE TRANSFEROHUNI NË EUROPEAN UNIVERSITY NË BARCELONË, MUNIH, GJENEVE APO MONTREUX.

PROGRAMET

EKONOMIK DHE MENAXHMENT

- Teknologji Informative në Biznes
- Menaxhment
- Banka, Financa dhe Kontabilitet

JURIDIK I PËRGJITHSHËM

- Administrativ – Kushtetues
- Juridik – Penal
- Juridik – Civil
- Juridik – Financiar



**EUROPEAN
COLLEGE
OF KOSOVO**

Programet akademike sipas praktikave europiane përfshijnë edhe vizitat studimore në institucione dhe kompani të suksesshme, mysafir folës, vendor dhe ndërkombëtarë, si dhe trajnime falas për studentët.

TRANSFERIMET

Studentëve të Kolegjit European të Kosovës u ofrohet mundësia për transferim në European University në Barcelonë, Gjenevë, Munih apo Montro, Manhattan Institute of Management në New York apo dhe në universitete tjera të njohura ndërkombëtare.

BURSAT

Kolegji European i Kosovës ofron bursa të meritës dhe bursa sociale për shkollim. Bursa e Meritës mbulon shpenzimet për shkollim të nxënësve shembullorë, ndërsa bursa sociale krijon mundësinë e mbulimit të shpenzimeve të shkollimit për kategori të veçanta sociale.

KONTAKTI

www.eck-edu.org / info@eck-edu.org
038 22 28 28 / 044 97 28 28 / 049 87 28 28